

Ndodhur para rrethanave që u parashtruan me lart, pasi dëgjoi edhe një here kerkesën e perfaqësueses ligjore të ankueses Xhoana Virgjil Nano - av Evelina Qirjako, për vazhdimin e gjykimit dhe paraqitjen në Kuvendin e Shqipërise te kërkesës për dhënien e autorizimit për procedimin penal të deputetit Nikollë Pal Lesi, përfaqësuesin e Prokurorisë së Përgjithëshme - prokurorin Artur Selmani, i cili kërkesës së gjykatës për t'u shprehur në lidhje me këtë çështje, iu pergjigj se jane kushtet për të kërkuar autorizim për procedim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, arriti në përfundimin se ekzistojnë kushtet që kërkohen nga ligji për t'i paraqitur Kuvendit të Shqipërise, kërkesën për dhënie autorizimi për procedimin penal të deputetit Nikollë Pal Lesi, për t'iu dhene mundesia shqyrtimit të plotë gjyqësor, sipas procedurave të parashikuara nga Kodi i Proredurës Penale, pretendimeve të ankueses në ngarkim të tij.

9

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 73/2 e 141/1 të Kushtetutës së Shqipërise dhe neneve 58-68 e 288 te Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI

Të kërkojë nga Kuvendi i Shqipërise autorizimin për procedim të deputetit Nikollë Pal Lesi, për kundërvajtjet penale të fyerjes dhe shpifjes, parashikuar nga nenet 119/II e 120/II të Kodit të Procedurës Penale.

U shpall me 24.09.2004
Tiranë me, 24.09.2004

ANËTAR
Perikli ZAHARIA

ANËTAR
Spiro SPIRO

KRYESUES
Kristaq NGJELA

ANËTAR
Ylivi MYRTJA

ANËTAR
Artan HOXHA